

VENDIM
Nr. 227, datë 17.4.2019

**PËR PËRGATITJEN, SHTYPJEN, BOTIMIN DHE SHPËRNDARJEN E
TEKSTEVE SHKOLLORE TË ARSIMIT BAZË PËR NXËNËSIT E
INSTITUCIONEVE ARSIMORE PUBLIKE PARAUNIVERSITARE, KU MËSOJNË
NXËNËS TË PAKICAVE KOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 47, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 13, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria përgjegjëse për arsimin siguron shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare.

2. Lista e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, përcaktohet nga ministria përgjegjëse për arsimin, në përputhje me nevojat e evidentuara për çdo vit shkollor.

3. Tekstet shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, të përgatitura e që janë gjendje pranë strukturave shtetërore, kalojnë në administrim të ministrisë përgjegjëse për arsimin, e cila i riboton këto tekste, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi për prokurimin publik, duke respektuar të drejtat e detyrimit lidhur me këto tekste.

4. Ministria përgjegjëse për arsimin siguron përkthimin e teksteve të katalogut zyrtar të teksteve shkollore, nga gjuha shqipe në gjuhën e pakicës kombëtare, në përputhje me lëndët mësimore që zhvillohen në arsimin bazë, të cilat nuk janë gjendje, sipas përcaktimit të pikës 3, të këtij vendimi.

5. Për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, për secilën prej gjuhëve amtare të pakicave kombëtare përkthehet vetëm një alternativë nga katalogu zyrtar i teksteve shkollore. Alternativa që do të përkthehet do të jetë teksti shkollor më i përzgjedhur nga mësuesit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare. Teksti i përzgjedhur dhe i përkthyer nuk ndryshon deri në ndryshimin e programit mësimor.

6. Të drejtën për përkthimin, botimin dhe shpërndarjen e tekstit shkollor, sipas pikës 5, të këtij vendimi, e ka shtëpia botuese që gëzon të drejtat për tekstin shkollor.

7. Procedura për përkthimin, botimin dhe shpërndarjen e tekstit shkollor të përcaktuar në pikat 5 e 6, të këtij vendimi, realizohet sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi për prokurimin publik.

8. Në rastet kur shtëpia botuese nuk mund të realizojë përkthimin, botimin dhe shpërndarjen e tekstit shkollor, sipas pikës 5, të këtij vendimi, të drejtat i kalojnë ministrisë përgjegjëse për arsimin, e cila përkthen, shtyp, boton dhe shpërndan tekstet shkollore, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

9. Për hartimin e teksteve shkollore të reja në gjuhën amtare të pakicave kombëtare, të cilat nuk janë gjendje, sipas përcaktimit të pikave 2 e 3, të këtij vendimi, dhe nuk janë pjesë e katalogut zyrtar të teksteve shkollore, institucioni përgjegjës për zhvillimin e metodologjive dhe të standardeve për tekstet mësimore apo sigurimin e cilësisë së arritjeve në arsimin parauniversitar, në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për secilin tekst shkollor, formon grupet e

autorëve dhe komisionet e posaçme për përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e teksteve. Anëtarët e grupeve dhe të komisioneve paguhën sipas akteve nënligjore në fuqi.

10. Tekstet e miratuara nga komisionet e posaçme të ngritura nga institucioni përgjegjës për zhvillimin e metodologjive dhe të standardeve për tekstet mësimore apo sigurimin e cilësisë së arritjeve në arsimin parauniversitar, në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, i paraqiten ministrisë përgjegjëse për arsimin, e cila i boton këto tekste, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi për prokurimin publik, duke respektuar të drejtat e detyrimet lidhur me këto tekste.

11. Kërkesat për pajisjen me tekste shkollore për nxënësit e pakicave kombëtare, që mësojnë në institucionet arsimore publike të arsimit bazë, dërgohen në ministrinë përgjegjëse për arsimin nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, brenda muajit janar të çdo viti. Përfundimisht, për vitin shkollor 2019–2020, kërkesat paraqiten brenda muajit prill 2019.

12. Kostoja e përgatitjes, shtypjes, botimit dhe shpërndarjes së teksteve shkollore të arsimit bazë, për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, mbulohet nga fondet buxhetore të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

13. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucioni përgjegjës për zhvillimin e metodologjive dhe të standardeve për tekstet mësimore apo sigurimin e cilësisë së arritjeve në arsimin parauniversitar, në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe institucionet arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe